Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 1441/24
Date 23.12.24

Prishtinë, 17.12.2024
Kodi i ZRRE-së: V_2590_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 5 dhe 6, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, , të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike të INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K, Numri i licencës ZRRE/Li_95/23 dhe
- Kërkesës me shkrim të datës 17 maj 2024 për ndryshim kontrolli – të bërë nga përfaqësues të INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K, me adresë Rr. Garibaldi 17/5, Hyrja 1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 17.12.2024 nxori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET ndryshimi në kontroll** i INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K (Numri Unik Identifikues 812059998), Numri i licencës ZRRE/Li_95/23, aktiviteti i Furnizimit me Energji Elektrike.

II. **Obligohet** aksionari tek te i cili kalojnë 51% e aksioneve të INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K të veproj sipas dispozitave të licencës së sipërpërmendur dhe legjislacionit tjetër në fuqi, nga data e aprovimit të ndryshimit në kontroll. I njëjti duhet të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për këtë subjekt, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 17 maj 2024 ka pranuar një Kërkesë për ndryshim kontrolli të ndërmarrjes INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K (shitje të aksioneve), nga përfaqësuesi, njëkohësisht aksionari i pesëdhjetë e një përqind (51%) të aksioneve të kësaj ndërmarrjeje z. Besim Hetemi për shitje të tyre në tërësi te z. Granit Shehu, jurist.

- Njëkohësisht me datë 17 maj 2024 ZRRE ka pranuar shkresë nga z. Granit Shahu, i cili ka KONFIRMAUR që pesëdhjetë e një përqind (51%) e aksioneve të kalojnë në pronësi të tij, pas aprovimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe në pajtim me legjislacionin tjetër në fuqi.

- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 28 dhjetor 2023 kishte licencuar ndërmarrjen INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K për aktivitetit e furnizimit me energji elektrike, me numër licence ZRRE/Li_95/23, ku sipas Nenit 16 të licencës kërkohet, citoj: *"I licencuari do të njoftojë Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritet të kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë, paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv derisa Rregullatori nuk e aprovon".*

- Gjithashtu sipas Nenit 15 paragrafi 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, parashihet, citoj: *"Ndërmarrjet e energjisë të licencuara nga Rregullatori duhet të aplikojnë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në përputhje me Ligjin për Konkurrencën, lidhur me vendimet për bashkim të ndërmarrjeve ose çfarëdo ndryshimi tjetër të kontrollit mbi ndërmarrjen e licencuar. Në këto raste, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës merr parasysh mendimin e Rregullatorit."* Bazuar në këtë me datë 06 nëntor 2024 pala është udhëzuar të informoj ZRRE nëse kishte marr ndonjë informacion/shkresë/përgjigje apo nëse në çfarëdo forme kishte kontaktuar Autoritetin e Konkurrencës lidhur me ndryshimin në kontroll.

- Me datë 7 nëntor 2024 INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K njofton ZRRE-në me e-mail se pas konsultimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurencës Nr. 08/L-056 dhe Nenit 15 paragrafit 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, konsideron se struktura e aksionarëve të kësaj shoqërie nuk krijon një obligim për të njoftuar Autoritetin e Konkurencës pasi që ndërmarrjet kanë për obligim që të njoftojnë këtë autoritet vetëm në rastet e përqëndrimeve (Neni 13 i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës). Për më tepër, dispozitat përkatëse detyrojnë njoftimin dhe marrjen paraprake të miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës vetëm në ato raste kur ndërmarrjet që janë palë në përqendrim arrijnë një nivel të caktuar të qarkullimit në tregun e brendshëm ose ndërkombëtar, dhe ku shuma minimale në skenarin më të mirë është mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm. Prandaj INFINIT POWER SOLUTIONS ka konsideruar se është e detyruar të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës vetëm në rastet kur kryhet një bashkim ose ndryshim kontrolli midis dy shoqërive të pavarura që arrijnë një prag të caktuar të qarkullimit vjetor. Ndërsa në rastin konkret nuk kishte bashkim mes dy shoqërive të pavarura por ndryshim të një aksionari individual për çka ky transferim aksionesh nuk kërkonte njoftim tek Autoriteti i Konkurrencës, sipas INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K.

- Me datë 8 nëntor 2024 INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K ka dorëzuar në ZRRE edhe Statutin e ndryshuar të këtij subjekti, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Statuti i dorëzuar në ZRRE gjatë aplikimit për licencë të furnizimit me energji elektrike përmbante dispozita lidhur me ndarje të aksioneve, andaj në këtë rast pala ka vepruar në pajtim me dispozitat e Nenit 25 paragrafi 3 të licencës për furnizim me energji elektrike Nr ZRRE/Li_95/23.

- Me kërkesë të ZRRE-së, me datë 14 nëntor 2024 INFINIT POWER SOLUTIONS i është drejtuar Autoritetit Kosovar të Konkurrencës lidhur me çështjen e ndryshimit në kontroll siç kërkohet edhe me Nenin 15 paragrafin 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

- Me datë 18 nëntor 2024 Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në komunikimet me INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K dhe ZRRE-në, dokumentet (kontratat), prezantimin e të dhënave, gjendjen e përshkruar të strukturës së ndërmarrjes INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K NUI-812059998 në tregun përkatës, ka vlerësuar se transaksioni nuk bie në dispozitat e Nenit 13 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet Detyrimit për të Kërkuar Lejimin e Përqendrimit, sipas këtij ligji.

- Rregullatori pas vlerësimit të kërkesës së INFINIT POWER SOLUTION dhe dëshmive/komunikimeve tjera të sipërpërmendura dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes **INFINIT POWER SOLUTIONS SH.P.K** dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Bucaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Prenqi, Anëtar

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (ish ndërtesa e Fazitës), Kati II, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org